

Dashmir Idrizi, PhD¹

UDC: 316.774:004.738.5
070.422:004.738

VENDI I GAZETARIT NË EPOKËN E INTERNETIT

МЕСТОТО НА НОВИНАРОТ ВО ВРЕМЕ НА ИНТЕРНЕТ

THE JOURNALIST'S PLACE IN THE AGE OF THE INTERNET

Abstract

The medias today are the main pillar of information, they have provided the space for readers to be informed in the fastest time possible and to be able to exchange their opinions, concerns and their preferences. If before people were communicating with letters, inviting each other for a coffee by invitation (paper form), now we have already moved into the era of internet and SMS where with a message we carry out our gatherings that we have planned.

In the past, up until 20 years ago, we used to find the newspapers every morning at home, in an ordinary coffee, on the street, it was found everywhere. For people, it as well turned into an entertainment. Luckily, the way to be informed has changed a lot, now it's in our pocket. But the question arises whether we are informed by social networks, websites, portals, electronic newspapers, Facebook, Instagram, Tik Tok or are we disinformed. How much did the internet help informing? or did it become the reason why some newspapers in RMV were closed?

Keywords: *newspapers, press, information, internet, social networks, right..*

Hyrje

Përdorimi i gjerë i internetit i ka mundësuar shoqërisë që të shfaq aftësitë që posedon dhe të veprojë në mënyra të ndryshme me qëllim që të tregojë veten në një fushë të caktuar. Tanimë jemi në një epokë ku mbretëron teknologjia, epokë e cila mund të quhet si “me dy fytyra” pasi aq sa të mira na

¹ University of Tetovo, Faculty of Law - Journalism. Email: dashmir.idrizi@unite.edu.mk

sjell, ajo pa dyshim se mbart edhe anët negative të cilat nuk janë edhe të vogla. Në internet të gjithë e dimë se rreziku primar i cili na kanoset është shqetësimi për shkeljen e privatësisë, si dhe keqpërdorimi i fotografive tona nga dikush tjetër e që paraqitet sikur të jemi ne, në fakt në një adresë të caktuar, edhe pse normalisht që edhe kjo ka zgjidhje, por gjithsesi është një fenomen shqetësues i kohëve të fundit, sidomos për ata që nuk kanë njohuri të mjaftueshme të teknologjisë e që nuk mundën t'i largohen këtij kërcënimi lehtë.

Në këtë temë do të diskutohet koha e sotme ku njerëzit thellësisht janë futur në botën e teknologjisë. Duke analizuar rrjedhën se si teknologjia pushtoi botën me mjetet më elementare të jetës së njeriut duke arritur në ato më luksoze, e të cilat janë duke u shndërruar në më të “patjetërsueshmet” si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit.

Ky punim do të përfshijë të dhëna në lidhje me funksionimin në këtë kohë të vështirë të gazetarisë së shkruar dhe mundësisë së informimit korrekt dhe të saktë të lexuesit, pasi fatkeqësisht përmes dritares informative të Internetit “portaleve, ueb-faqeve, Facebookut” dhe shumë rrjeteve të tjera sociale lexuesi nuk informohet por dezinformohet, dhe këto rrjete janë bërë si kërpuhat pas shiut, dhe sa vijnë e po shtohen pa asnjëfarë cilësie sa i përket informimit.

Nga shtypi tek interneti

Fatmirësisht, mediat u kanë ofruar hapësirë njerëzve të komunikojnë në kohë dhe të mund të shkëmbejnë mendimet, shqetësimet si dhe pëlqimet e tyre.

Në fillim ishin gazetat² ato nga të cilat buronte lajmi, madje lajmet më të besueshme njerëzit i gjenin aty. Në mëngjes në shtëpi, në kafenenë e zakonshme, në rrugë, e gjenin atë kudo. Madje për njerëzit kjo u kthye edhe një lloj argëtimi. Njerëzit e kishin këtë edhe si një aktivitet, ata në kohën e lirë, para apo pas buke (me përjashtim të darkës) lexonin informacione të ndryshme, po ashtu edhe batuta të llojllojshme që zakonisht i gjenin në fund të fletës. Gjatë kohës së udhëtimeve dhe pritjeve të gjata nëpër salla të ndryshme gazeta u ndihmonte pasagjerëve që të kalojnë më shpejtë kohën e bezdisshme dhe po ashtu zbuti pritjet e pafundme nëpër korridore.

Drejtuësit e gazetave nuk mund ta lejonin që t'u ikë ky detaj. Andaj ata shtuan rubrikat me përmbajtje argëtuese, fjalëkryqet, lojërat me letra e ato matematikore etj. “Të thuash se shtypi ka funksion argëtues do të thotë të paraqesësh atë si psikoterapeutik”. (Stoetzel)

Ndërkohë që përveç pjesës argëtuese ajo që e bënte efektive shtypin ishte edhe fakti që njerëzit kishin hapësirë të veçantë për të paraqitur çdo shqetësim të tyre. Përfshirë këtu dhunën, vjedhjen, propaganda të ndryshme dhe

² Mediat dhe shoqëritë, botimi I, 15 Francis Balle f. 626. Informacion i rëndësishëm për temën e parashtruar, duke i dhënë më shumë kuptim kapërcimit nga një media e shumë përdorur në një media tashmë të “harruar” apo të lënë pasdore.

ndodhi të tjera shoqërore. Në këtë fushë pa dyshim që edhe kompjuterizimi i shoqërisë e bëri të veten, tashmë njerëzit u futën në një epokë tjetër ku për të shprehur ndonjë shqetësim të tyre ata as nuk duhet të raportojnë nëpër media (apo të vrapojnë pas mediave), ata thjeshtë bëjnë një “shpërndarje” të lajmit në rrjetet sociale (Facebook, Twitter) dhe media është ajo që i ndjek ata nga pas.

Sidoqoftë, këto të mira që kishte gazeta nuk arritën ta shpëtojnë atë nga “përmbytja”. Pasi me lindjen e Internetit, gazeta nuk arriti ta kalojë këtë sprovë siç duket.

Me arritjen e këtij fenomeni, tirazhi³ i gazetave dhe fitimi nga reklamat në gazetë filloi të binte ndjeshëm, fitimi shkonte në ulje me një shpejtësi të paparamenduar.

Ishte “The Sun” gazeta britanike e cila kishte një tirazh prej më shumë se 3 milionë kopje në vitin 2010; por që me vonë kishte rënë në 1.7 milionë.

Sipas “Balkans Web”, “The Daily Telegraph” kishte pësuar rënie nga 691000 në 488500 në po të njëjtën periudhë; Ndërkaq, “The Guardian” nga 302000 në 166500. Kurse “The Independent” mbylli tërësisht redaksinë e saj. Që nga viti 2005, shumë gazeta lokale janë mbyllur në pjesën perëndimore të globit.

Pra, interneti tashmë dukshëm ka pasur ndikim negativ në shtypin ditor, në nivel botëror. Përballë gazetave numri i të cilave është në rënie e sipër, dhe janë disa që bëjnë luftë për të mbijetuar. Sepse, tashmë dihet se shumica e lexuesve konsumojnë të rejtat e fundit në versionin online dhe më e mira e kësaj, është se ata e marrin lajmin tërësisht falas. Interneti rezulton të jetë më i shpejtë dhe burim informacioni më i “besueshëm” në këtë rast edhe për disa kategori të tjera informacioni siç janë: Moti, kurset e këmbimit të valutave, bursa, trafiku rrugor, njoftimet e biznesit dhe të komunitetit, tregu i punës (“kërkoj punë-ofroj punë”), po ashtu edhe informacioni i klasifikuar i tipit “shes-blej - jap me qira”.

Pa dyshim që ky drejtim kërkon përkushtim të madh përveç nga Qeveria po ashtu edhe nga vetë studentët të cilët duhet të kenë dëshirën dhe vullnetin për punë, por siç ceket më lartë motivimi që mund t’u ofrohet atyre pa dyshim është edhe ai financiar.

Vendi i gazetarit në epokën e internetit

Tashmë secili mund të bëhet media, të prodhojë, të japë, shpërndajë informacione pa masë, madje të çdo fushe. Kjo falë mundësisë që ofron interneti që secili të botojë dhe prodhojë lajme, kronika etj. Çdo qytetar i interesuar për të shpërndarë informacion tashmë këtë e bën pa problem, nga çdo ngjarje në të cilën ai qëllon aty rastësisht bën lajm dhe automatikisht e shndërron veten në gazetar. Me shpenzime minimale, duke mos pasur nevojë për

³ <http://balkanweb.com/site/vdekja-e-gazetes-dhe-interneti/> - Një lajm i botuar me përmbajtje statistikore rreth gazetave të cilat humbën prestigjin me arritjen e internetit.

redaktim. Madje pa kaluar asnjë filtër të përzgjedhjes të mediave tradicionale, tashmë gazetaria është një zanat ku çdo kush e vjedh nga tjetri pa u munduar të shkollohet për këtë të fundit. Por shtrohet pyetja sa janë të besueshme këto informacione? Apo a duhet t'u besohet të njëjtave? Analizues të ndryshëm këtë fenomen e krahasojnë me "cunami", të përmasave të paparapara në historinë e zhvillimit të mediave, që ka ndikuar jashtë mase modelet e funksionimit të mediave tashmë të cilësuar "media tradicionale".

Nëse nuk e dimë nga vjen informacioni, dhe nga kush është përgatitur, atëherë pse duhet besuar? Jo rastësisht jemi në këtë gjendje ku jemi, dhe fatkeqësisht vazhdojmë t'u "besojmë" fjalëve të kota të portaleve, askush nuk pyet çka po ndodh me informimin jo vetëm në RMV, por edhe më gjerë.

Andaj të gjitha shtëpitë informative, qofshin të shkruara, audiovizuale, apo audio (radio) pse jo edhe ato elektronike duhet të kenë të punësuar gazetar të diplomuar me fakultet përkatës të gazetarisë, e jo t'i japin të drejtë çdo qytetari që të punojë në rolin e gazetarit. Përndryshe na presin kohëra edhe më të vështira sa i përket informimit apo dezinformimit.

Si rezultat i kësaj ndodh që nga frekuentimi i shumtë i mediave online, ato tradicionale edhe po shuhet, ose të konsiderohen si të paafta për përballje me revolucionin teknologjik të kohës së sotme. Ajo që ka ndryshuar është gjithashtu edhe audiencia. Andaj, studiuesit e mirënjohur vlerësojnë se gazetaria po bëhet dita ditës më e ndërlikuar. Piktura e re mediatike që është krijuar nga interneti vazhdimisht na kthen në pyetjen e madhe dhe të padiskutueshme në historinë e gazetarisë se: a kemi nevojë më për gazetarët?! Përderisa çdo kush është i aftë të prodhojë informacione; në qoftë se kanalet e komunikimit tashmë janë të servuara gjithandej, nëse nuk ka nevojë më për një medium nga i cili përcillet mesazhi gjegjësisht informacioni, lind pyetja, atëherë realisht a na nevojiten gazetarë?

"Zgjidhja për infobezitetin është gazetaria",⁴ argumenton fuqishëm Scherer. Por, çfarë gazetarie dhe çfarë gazetarësh flasim? Ai e cilëson "gazetari me vlerë të shtuar".

Studiues të tjerë e cilësojnë "gazetari tjetër - gazetari e re" që përfshin edhe ndryshimin e statusit të gazetarit dhe transformimin e tij në "gazetar shumëdimensional".

Sipas Scherer gazetarët mbajnë "aksin kryesor" në duart e tyre, informacioni me bazë cilësore, i vërtetuar mirë ofrohet vetëm nga gazetarë profesionistë, që dallojnë nga informacionet të cilat jemi mësuar t'i konsumojmë nga portalet e ndryshme të cilat pa asnjë lloj burimi të informacionit publikojnë lajme nga më të ndryshmet. Parimet e konsoliduara gjithmonë është e nevojshme që të transmetohen tek mediat moderne, përmes kanaleve të shumta që na i ofron tashmë interneti. Sidoqoftë, pas kohës së kaosit dhe të

⁴ <http://illyriapress.com/gazetari-ne-epoken-e-internetit/> - citim.

euforisë së krijuar nga risia - vjen periudha ku rëndësia do t'i rikthehet periudhës së reflektimit dhe vlerave. Së fundi, vlera gjendet tek profesionistët, bartësit e "vjetër" të misionit të dobishëm për shoqërinë që të rishfaqen në skenë. "Në një kohë kur shtypi nuk është më një monopol, ai duhet ta fitojë autoritetin e tij duke siguruar dije".

Ashtu siç edhe e shohim, besueshmëria e plotë e shoqërisë vazhdojnë të jenë lajmet që ndiqen nga mediat tradicionale: gazeta, TV dhe radio, e jo siç po ndodh tani lajmet që konsumojmë në portale nuk janë dhe aq të besueshme për to, andaj edhe konfirmimin e plotë të këtij të fundit njerëzit zakonisht e presin në lajmet e TV-së apo në shtyp. Kjo dhe mund të quhet se është fuqia e gazetarisë në periudhën e internetit. Sidomos, në periudha të vështira p.sh. luftë, zgjedhjet, vrasje, apo çfarëdo ngjarje që prek interesin e përgjithshëm, vetëm gazetari i përgatitur mirë me aftësinë e tij për të përzgjedhur në morinë e fakteve dhe për t'i verifikuar dhe shndërruar ato në dobi të shoqërisë, i plotëson nevojat e thjeshtësisht të mbingarkimit të informacionit.

Tashmë vlera e shtuar e gazetarisë anon kah trajtimi cilësor e jo në furnizimin e informacionit, pasi janë të shumtë ata që shpërndajnë lajme, por shoqëria ka nevojë për lajme produktive dhe të kapshme për lexuesit. Mirëpo, vlera e dobisë së përgjithshme e informacionit shkon në rritje me vendosjen e këtij të fundit në funksion të kërkimit të së vërtetës. Kohach dhe Rosenstiel vlerësojnë se shtypi në të ardhmen do të rifitojë integritetin e vet varësisht nga lloji i përmbajtjes që do të shpërndajë, por jo nga roli i tij ekskluziv si furnizues i vetëm i informacionit ose si ndërmjetës mes lajmbërësve dhe publikut".

Në bazë të kësaj që shohim në këtë kohë, si duket gazetaria e shekullit të ri do të duhet të përpunojë modele të reja me qëllim që t'i përshtatet audiencës e cila pretendohet të jenë gjithnjë më aktive se këto të tanishmet.

Çdo informacion i përfituar nga qytetari raportues pa dyshim se mund të jetë i dobishëm në disa raste, por si bazë fillestare për ta gjurmuar lajmin, jo të publikohet pa e konfirmur. Mirëpo, përgjegjësia për mirëmbajtjen edhe të rendit shoqërorë deri diku varet edhe nga gazetaria, pasi e dimë se është një fushë e cila kryen funksionimin e të mirës publike, dhe si e tillë nga ajo kërkohet më shumë përqendrim tek mënyra e raportimit, që të kemi raportim cilësor dhe efikas.

Ndërkaq, ky mision i vjetër vazhdon t'i japë një formë dhe të arrihet të bëhet dallimi ndërmjet informacionit cilësor të përpunuar, atij gazetaresk dhe të atij që vjen nga njerëz të rëndomtë që kyçen në internet për të kryer informacione. Ndër të tjera, në epokën e mbingarkesës me informacion, gazetaria dhe gazetari do të duhet t'u përshtatet imponimeve të reja që do të arrin me kalimin e kohës, me qëllim që të luftojnë revolucionin teknologjik i cili do të na vijë me kohë. Mjetet e raportuesit qytetar janë më të thjeshta, ndërsa cilësia e raportimit e pakrahasueshme me atë të gazetarit, por megjithatë ka rol të rëndësishëm në shoqëri. Njëkohësisht, ajo që duhet të dimë është se gazetari duhet me përpikëri

të zbatojë dhe të ndikojë në vlerat profesionale dhe etike gazetareske e jo qytetari raportues dhe komunikuesit e rëndomtë në rrjetet sociale.

Mbase interneti është një sprovë e madhe për gazetarinë profesionale, mirëpo nuk sjell fundin e kësaj të fundit. Revolucioni digjital⁵ shënon kthesën drejt një gazetarie ku përshtaten parimet e vlerat e konsoliduara të përmbajtjes me shumësinë e kanaleve për kryerjen e misionit të saj shoqëror.

Shfrytëzimi masovik i internetit dhe audienca

Më lartë kemi cekur shkurtimisht punët që na i kryen interneti për çdo nevojë që ne kemi, madje edhe për çdo kënaqësi tonën. Por, në këtë pjesë do të shtjellojmë më hollësisht përdorimin dhe ndjekjen e audiencës në këtë të fundit. Interneti hap pas hapi i ka dhënë një kahje tjetër monotonisë sonë dhe na shkëput nga pak edhe nga realiteti, duke na dhënë kështu hapësirë t'u shmangemi gjërave të padëshiruara, qoftë ata edhe të jenë të nevojshme ne zgjedhim që të "argëtohem" apo "të harrohemi" në internet duke u ikur kështu dhe përgjegjësi, apo thjesht duke mos u dhënë rëndësi gjërave më të mëdha se sa ulja para kompjuterit apo para telefonit tonë të mençur. Por e vërteta është se interneti na shpie në një horizont të pafund ku ne plotësojmë edhe dëshirat dhe nevojat tona për të mësuar, pa marrë parasysh se a janë ato njohuri të përgjithshme apo specifike.

Pa dyshim që internetit ia panë anën e mirë edhe bizneset, ku ata tashmë mund të reklamojnë produktet, rrobat apo çfarëdo që zotërojnë ato nëpërmjet rrjeteve sociale.

Interneti fillimisht u bë i njohur për qasjen deri te informacionet e pafundme të çfarëdo fushe qofshin ato shoqërore, botës, sportit, teknologjisë, kulturës, politikës, hapësirës etj.

Ai na mundëson edhe pjesëmarrjen në organizata të ndryshme qeveritare dhe në ato joqeveritare. Me ndihmën e tij, shumë njerëz kanë marrë iniciativën të jenë në ndihmë të shoqërisë tonë. Nëpërmjet këtij fenomeni çdokush mund të shpreh kënaqësitë apo pakënaqësitë e veta, të shpreh bindjet e veta qofshin ato religjioze, shoqërore madje pa asnjë paragjykim. Falë internetit ne kemi arritur të dimë shumëçka rreth kulturave të ndryshme në botë, të cilat nuk e kanë vëmendjen e duhur nga mediat, por që neve na kryejnë punë për njohuritë tona të përgjithshme.

Madje, tashmë gjeneratave të reja u është ofruar mundësia e artë që nëpërmjet internetit të interesohen për universitete jashtë vendit, duke bërë përzgjedhjen e mundur, pasi çdo informacion të nevojshëm ata e gjejnë në Google.

Duke e kursyer kështu edhe kohën për të mos shkuar derë në derë për ta marrë atë informacion të cilin e do nxënësi apo studenti, por pse jo edhe

⁵ <http://illyriapress.com/gazetari-ne-epoken-e-internetit/> - Ndryshimet rrënjësore që pësuan e revolucionin digjital, sprovë e madhe e mediave tradicionale dhe profesionit të gazetarit.

prindërit. Tashmë pritet që e gjithë shoqëria të përfshihet në botën e teknologjisë në të cilën pa dyshim që si pikë të parë e hasim internetin, sepse ai po bëhet pjesë e përditshmërisë sonë me apo pa dëshirën tonë.

Sipas hulumtimeve⁶ të bëra, rreth 40% e popullsisë botërore sot janë të kyçur në internet. Përdorimi i tij është rritur dhjetë herë më shumë që nga viti 1999 deri në vitin 2013, ndërkohë që në vitin 1995, frekuentimi në këtë të fundit ishte fare i ulët sa që u llogariste më pak se 1% në të gjithë botën.

Viti 2005 solli miliardin e parë të shfrytëzuesve të internetit, miliarda e dytë erdhi menjëherë pas pesë vitesh (viti 2010) e ndërkaq, miliarda e tretë arriti jo më larg se në vitin 2014.

Megjithatë, ajo që ka po ashtu rëndësi të madhe dhe që duhet përmendur është ajo pjesa ku interneti e ka edhe anën e errët. Megjithëse ai na siguron informacione të vlefshme, na argëton dhe të gjitha ata që kemi cekur më lartë.

Interneti mund edhe të na keqinformojë, të na harxhojë kohën për së tepërmi dhe pa asnjë rezultat si dhe të ndikojë edhe në prishjen e moralit. Për atë, ky është një detaj të cilin nuk duhet lëshuar dhe që ka nevojë për të analizuar gjerë e gjatë, sepse bart pasoja serioze për ne, fëmijët apo edhe për dashamirët tanë.

Në momentin kur neve kyçemi në internet duhet të kemi parasysh se duhet të mbrohemi nga rreziqet që na kanosen nga ky i fundit. Normalisht se neve duhet që të lexojmë informacionet me një sy kritik, mos të pranojmë atë që e shohim saktë siç na servohet, por të analizojmë edhe nga këndvështrimet e tjera.

Ajo që duhet marrë parasysh është se, secili mund të kyçet në internet, të hapë një faqe informative apo quajtur ndryshe një portal informativ dhe të postojë lajme të pa bazuara asgjëkund, por që faqja posedon numër të madh ndjekësish të cilët pa vetëdije i konsumojnë ato lajme, dhe më vonë ndodh ajo që i frikohemi, domethënë përhapen keqkuptime në lidhje me çështjet edhe që janë të rëndësishme, siç janë p.sh. periudha kur kemi zgjedhje në vend, e më pas që banalizohen lajmet për rezultatet përfundimtare. Andaj, gjithsecili duhet të dijë nga e merr lajmin, të zgjedhë burime të besueshme dhe të jetë i aftë ta dallojë të drejtën dhe “të shtrembëtën”.

Kur flasim për këtë gjithmonë na shkon në mendje koha që harxhojmë tek sa e përdorim internetin. Për disa, interneti është bërë një lodër tërheqëse për ta kaluar kohën e duke harruar se mund ta kthejnë atë në një gjë të dobishme për to.

Rreziku i rëndësishëm që kanoset në këtë periudhë është varësia nga ky i fundit, ndër të tjera rrezikohet edhe izolimi në vetvete i individit duke u shmangur kështu nga takimet me shokët, bisedat familjare apo edhe të lozurit

⁶ <http://www.internetlivestats.com/internet-users/> - Statistika të cilat dëshmojnë përdorimin e tepruar të këtij rrjeti që po bën bujë në këtë kohë, dukë e quajtur këtë periudhë kohore si “Epoka e Internetit”.

jashtë. Ky është një faktor i rëndësishëm që po bën bujë në këto kohëra, madje është edhe më i rrezikshmi, sepse jo vetëm të mëdhenjve, por dhe fëmijëve u kanoset ky rrezik që shkon dita ditës duke u përhapur më shumë.

Conclusion

During the analysis of the influence of social networks on the expression of thought, we concluded that social networks were the number one source from which people derive their social, political, and cultural influences. It is accepted that the latter have also affected the way of life of users who use these channels. The current networking, or as we mentioned during the subject, this “digital revolution,” has also challenged the work of many newspapers, where some of them were not strong enough to cope with the test of the century, and the price to be paid was the closure of the editorial houses.

Also, what is important to mention, and which is the basis for the media, both traditional and social media (new media), is ethics. Ethical codes hold a special place in the media world, as they are the primary rules for every editorial house. We already have online portals, blogs, and various social networks where it is difficult to control the ethical code, especially in these online media. However, to be professional and literal journalists, the ethical code of journalists should not be compromised, and it must be respected. We live in a democratic time where the free expression of thought is offered in many ways, on TV (through citizen surveys), on the internet (through numerous comments of citizens, although mainly negative ones, full of mischief). From this, we understand that social networks have actually influenced our lives more for good than bad. It depends on us how we will use this advantage gained.

Recensentë:

Doc.dr. Njomza Selimi Osmani

Prof.dr. Ebrar Ibraimi

Literatura e shfrytëzuar

1. Mediat dhe Shoqëritë, Botimi I 15-të, Francis Balle
2. Media, Interneti dhe Fëmijët, Albanian Media Institute (Instituti Shqiptar i Medias)
3. “Monologu” - Artan Fuga
4. Mediat sociale dhe përdorimi i tyre nga mediat shqiptare- Instituti Shqiptar i Medias, Tiranë,2015

5. Code of Ethics of Albanian Media - Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias
6. Ethis and Journalism in Albania - Albanian Media Institute, Instituti Shqiptar i Medias
7. <http://www.gazetadita.al/njerezit-i-marrin-lajmet-gjithnje-e-me-shume-nga-interneti/>
8. <http://illyriapress.com/gazetari-ne-epoken-e-internetit/>
9. <https://cs.stanford.edu/people/eroberts/cs181/projects/2010-11/Journalism/>
10. <https://fivethirtyeight.com/features/why-do-you-comment-online/>
11. <http://www.bbc.com/news/technology-13665452>
12. <https://plato.stanford.edu/entries/ethics-internet-research/>
13. <http://objektiv.al/interneti-zhvillim-dhe-rrezik/>